

VENDIM
Nr. 795, datë 28.12.2023

PËR SHPËRBLIMIN E PUNONJËSVE TË QEVERISJES QENDRORE NË PROCESIN E SHQYRTIMIT ANALITIK TË *ACQUIS (SCREENING)*, NË KUADËR TË PROCESIT TË NEGOCIATAVE ME BASHKIMIN EVROPIAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin për paraqitje të mirë të Republikës së Shqipërisë në procesin e shqyrtimit analitik të *acquis (screening)*, në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian, zhvilluar midis datave 15 shtator 2022 deri më 24 nëntor 2023, të punonjësve organikë të njësisë të qeverisjes qendrore, të cilët janë aktualisht në marrëdhënie pune në njësitë e qeverisjes qendrore, si më poshtë vijon:

a) Ministrin e Shtetit dhe Kryenegociator dhe negociatorët, të përcaktuar sipas vendimit nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, të ndryshuar, që kanë qenë në këtë pozicion përgjatë periudhës së parashikuar në këtë vendim;

b) Pjesëmarrësit e delegacionit të Republikës së Shqipërisë, si më poshtë vijon:

i. Personat të cilët kanë marrë pjesë (fizikisht) në takimet dypalëshe për shqyrtimin analitik të *acquis (Screening)*, në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian, në Bruksel;

ii. Prezantuesit *online* dhe mbështetësit *online*, sipas agjendave zyrtare dërguar shërbimeve të Komisionit Evropian të takimeve dypalëshe për shqyrtimin analitik të *acquis (Screening)*, në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian;

c) Kontribuesit në përgatitjen përmbajtjesore të takimeve dypalëshe për shqyrtimin analitik të *acquis (Screening)* për negociatat me Bashkimin Evropian, sipas kontributit në përgatitjet dhe paraqitjen e mirë, të përcaktuar nga çdo negociator për kapitull dhe/ose kriter, si më poshtë vijon:

i. Në masën deri në 10 punonjës kontribues për kapitull, për kapitujt 1, 11, 12, 14, 27;

ii. Në masën deri në 5 punonjës kontribues për kapitull, për kapitujt dhe kriteret e tjera;

ç) Sekretariatet e grupeve ndër-institucionale të punës për integrimin evropian (GNPIE), sipas urdhrit nr. 94, datë 20.5.2019, të Kryeministrit, si dhe sekretariati i përcaktuar, sipas pikës 3, të kreut V.1, të urdhrit nr. 57, datë 24.4.2023, të Kryeministrit;

d) Punonjësit e Departamentit të Politikës dhe Integritimit Evropian, në Kryeministri, si edhe të kabinetit të ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator;

dh) Ambasadori dhe personeli diplomatik i Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Evropian, në Bruksel.

2. Masa e shpërblimit të jetë një pagë mujore bruto, sipas pagës që nëpunësit përfitues, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, kanë në momentin e hyrjes në fuqi të tij, por jo më shumë se paga e funksionit ministër Shteti dhe Kryenegociator, dhe për një shpërblim të vetëm.

3. Negociatori në detyrë, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, konfirmon pranë institucioneve përkatëse, për çdo kapitull dhe/ose kriter, listën e punonjësve që përfitojnë shpërblimin, sipas shkronjave “b” dhe “c”, të pikës 1 të këtij vendimi.

4. Punonjësit sipas pikës 1, të këtij vendimi, të cilët kanë ndryshuar pozicionin e punës, por që janë ende në marrëdhënie pune në njësitë e qeverisjes qendrore, përfitojnë shpërblimin nga

institucioni përkatës ku kanë kontribuar për takimet dypalëshe, bazuar në konfirmimin nga negociatori përkatës për kapitullin dhe kriterin përkatës.

5. Efektet financiare të këtij vendimi përballohen nga fondi i veçantë, sipas nenit 12, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar me aktin normativ nr. 6, datë 14.12.2023, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 84/2022, ‘Për buxhetin e vitit 2023’”. Njësitë e qeverisjes qendrore paraqesin pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kërkesën për fonde shtesë, me qëllim ekzekutimin e këtij vendimi. Ministria e Financave dhe Ekonomisë miraton dhe alokon fondin përkatës.

6. Institucionet publike jobuxhetore shpërblejnë me burimet financiare të tyre punonjësit sipas pikës 1 të këtij vendimi.

7. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe njësitë e qeverisjes qendrore të kryejnë veprimet financiare për zbatimin e këtij vendimi deri në datën 15 janar 2024.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama